




KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË
SKUPŠTINA OPŠTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



PROCESVERBAL III/2025

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 3 (tretë) për vitin 2025 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 28.03.2025
Ora: 10:00

Prezentë në takim:

Z. Shefket Kolgeci
Z.Selman Kolgeci
Z. Flamur Bytyçi
Z. Urim Suka
Z. Kushtrim Kuçi
Znj. Elmaze Bytyqi
Znj. Bulëza Kuçi
Znj.Doruntina Zenelaj
Z.Alban Berisha
Z. Bexhet Kuçi
Z. Reshat Selimaj
Z. Lirim Qatani
Z. Aziz Bytyqi
Znj.Sanie Kuçi-
Rexhepaj
Znj.Fidaije Kukaj

Znj. Afërdita Morina
Z. Vullnet Luzhnica
Z. Xhevshet Gashi
Z.Edon Sadikaj
Znj.Saranda
Bajraktari
Znj.Mimoza Bajraktari
Znj.Festë Kabashi
Z.Dardan Berisha
Z.Bajram Basha
Znj.Mevlude Kabashi
Znj.Sheqerije Zyrapi
Znj.Laureta Tafaj
Z.Liridon Fandaj
Z.Qëndrim Elshani
Z.Herolind Limaj
Znj.Jehona Lumi
Rrafshi

Të pranishëm të tjerë

Kryetari Komunës
Media dhe qytetarë
OSCE, LMT, KDI
Znj.Habibe Bytyqi
Z.Xheladin Sadikaj

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi,i cili propozoi këtë:

REND DITE

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për këmbimin e pronës komunale me pronën private;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës se paluajtshme të Komunës;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës se paluajtshme të Komunës;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme;**
- 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-016-51839, të datës 30.08.2024;**
- 7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-12093;**
- 8. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm**
- 9. Pyetje dhe përgjigje;**

Kryesuesi - përshëndet të pranishmit dhe i njoftoi me rendin e ditës.E hedh në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet rendi i ditës

Kryesuesi - ZKF kërkon që të njoftoj dhe të jap sqarime për një vendim të cilin e kemi miratuar seancën e kaluar.

Fadil Hoxha - përshëndet të pranishmit.Kam një njoftim rreth bartjes të të hyrave vetanake teprice që e kemi bërë në janar.Shkresa na ka ardhë nga Drejtori i Buxhetit pasi është aprovuar nga ju dhe i është drejtuar Drejtorit të Financave dhe mua.Në këtë shkresë,te bartja dhe tejkalimi e të hyrave komunale vetanake e përmend ku thotë: në vendim duhet të specifikohet,nga kjo rrjedh se komuna ka të drejtën dhe kompoetencën e bartjes së mjeteve të pa shpenzuara vetanake në aktivitetet e projektet e reja apo ato ekzistuese ku komuna vlerëson arsyeshmërinë dhe prioritet në përputhje me legjislacionin në fuqi.Vetëm për këtë duhet të ofrojnë sqarime apo arsyeshmërinë e nevojshme në tekstin e vendimit komunal lidhur me aktivitetet dhe projektet për bartjen e mjeteve vetanake që mban përgjegjësi të plotë komuna.Ky vendim që është bërë e ka vetëm arsyeshmërinë dhe asgjë nuk ka të shtuar në tabelat që i kemi bërë,as shuma. ZKF tutje jep sqarime dhe thotë që Drejtori i Buxhetit ka kërku që në këtë tabelë me ia bashkangjit arsyeshmërinë dhe në fund me nënshkru Kryesuesi.Pra ky është vetëm si njoftim për ju.

Liridon Fandaj - përshëndet të pranishmit.Nëse nuk ka ndryshime,të paktën te arsyeshmëria me cek që kjo arsyeshmëri është dhënë pas miratimit të vendimit në Asamblenë komunale dhe mos t'jetë diçka që ju pe ndryshoni,ne jemi të njoftuar.Nëse nuk ceket kështu,atëherë duhet të shfuqizohet dhe të vijë prap.

Urim Suka - përshëndet të pranishmit.Kur projekt-vendimi që ne e kemi votu në janar dhe tash i shtohen sqarimet shtesë,unë mendoj që ndryshon vendimi.A ka ndryshu vendimi apo nuk ka ndryshu dhe a duhet

ne ta votojmë apo nuk duhet ta votojmë?Unë besoj që nëse vendimi ka ndryshu dhe për shkak të saj është kthi prej ministrisë,ne në një formë duhet me votu risht këtë vendim,duhet me qenë pikë e rendit të ditës. Nëse juristi thotë që gjithëçka është në rregull dhe mundemi me vazhdu,ne atë mirëbesimin edhe e japim por nuk mendoj që bëhet kështu.

Avni Bytyqi - përshëndet të pranishmit. Këtë çështje e kemi diskutu me Kryesuesin dhe me ZKF-në dhe meqenëse ky është vendim kolegjal që është marrë në Asamble dhe nuk është vetëm nënshkrimi i Kryesuesit.Unë kam kërku që së paku ta njofton Kuvendin nëse ju paraprakisht e jepni pëlqimin që Kryesuesi me ndërhy në çështje të nënshkrimit me plotësimin që e dha ZKF-ja për arsye se baza ligjore është këtu por prap mbetet në diskrecionin tuaj të vendosni sepse sqarimet e mia, opinionet, vërejtjet dhe rekomandimet e mia nuk janë obligative për juve. Ju jeni ata të cilët e merrni vendimin. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime dhe thotë që nëse ju vlerësoni që mund të ndërhyjë Kryesuesi dhe ZKF-ja me korigju atë gabim, atëherë është në rregull por nëse jo, atëherë vje vendimi me plotësim ndryshim.

Shefket Kolgeci - përshëndet të pranishmit.A e përfshin baza ligjore korigjimin teknik në këtë rast apo nuk e përfshin?Nëse e përfshin korigjimin teknik,ne po pajtohemi por nëse ka diçka më shumë,unë jam me Urimin ku tha që ndoshta duhet me votu prap.

Avni Bytyqi - sipas ZKF-së çështja e përmbajtjes së aktit administrativ nuk ka ndryshim.Te çështja financiare nuk ka asnjë cent ndryshim por është vetëm shtimi i arsytimit se si ka ardh deri te bartja e atyre mjeteve dhe si janë ndarë mjetet.

Urim Suka - neve me këtë njoftim po na kërkohet me ia dhënë besimin Kryesuesit me nënkshkru atë në bazë të sqarimit që ti e dhe. A duhet me votu ne për me ia dhënë këtë besim?Kjo mua nuk më duket në rregull.Përndryshe unë e inkurajoj dhe falemnderoj gadishmërinë për me na sqaru që ai ndryshim po bëhet.

Avni Bytyqi - është duke u mbajtë procesverbal dhe këto çështje konstatohen me procesverbal dhe mendoj që patjetër duhet me marrë votimin nga ju dhe pëlqimin nga ju nëse lejohet me plotësu dhe ndryshu atë vendim, nëse jo,vazhdojmë me procedurat tjera ligjore siq e kërkon ligji për vetqeverisje lokale dhe ligji për Financa të Pushtetit Lokal dhe ligji për menaxhimin e Financave Publike.

Aziz Bytyqi - përshëndet të pranishmit.Për deri sa nuk po ndryshon një vendim që tashmë është i miratuar po mendoj që ata e kanë marrë me të drejtë si përfaqësuesi i Kuvendit(Kryesuesi) me nënkshkru me që praktikisht këtu është shtu vetëm arsyeshmëria.Për deri sa nuk kemi ndryshim te përmbajtja e vendimit unë besoj që një informatë e tillë është e mjaftueshme.

Liridon Fandaj - nëse e hedh në votim,ne të paktën duhet me pas edhe një përmbajtje të atij pëlqimi që kemi me ta dhënë ty si Kryesues. Ju votat i keni dhe e kaloni këtë pëlqim por ministria e kthen vendimin. Mos na qitni në lajthitje neve pse i keni votat ju e doni me kalu ashtu qysh doni ju.Nëse vendimi nuk është shfuqizu dhe tash votohet një pëlqim,ne nuk e kemi as atë pëlqim dhe kjo është e kundërligjshme.

Urim Suka - shpjegimin që po e jep Azizi është për me i dhënë legjitimitet asaj që doni me bë dhe që mua më vjen keq për faktin që edhe vet është jurist. Vendimi është kthi prej ministrisë dhe një vendim kur të kthehet prej ministrisë,dihet cila është rruga.Mendoj që ne duhet me shfuqizu vendimin paraprak dhe me miratu një vendim të ri me këto ndryshime.

Avni Bytyqi - sa i përket kthimit të përgjigjes apo kthimit të vendimit të ministrisë, së paku as Kryetari dhe as Kryesuesi nuk kanë asnjë dokument zyrtar që vendimi është kthi në rishqyrtim por vetëm komunikimi që ka pas ZKF me Drejtorin e Buxhetit dhe ai ka kërku që në kuadër të vendimit të inkorporohet edhe arsyeshmëria e mjeteve dhe projekteve që janë bartë për vitin 2025 për shfrytëzim dhe shpenzim sepse nëse një çështje e tillë ekziston në komunë siq po pretendon ti, ne e kemi obligim ligjor që ta sjellim në kuvend dhe ti ndjekim procedurat.

Kryesuesi - zakonisht vendimet që i merr ministria për me i shqyrtu dhe në qoftëse nuk e merr formën e prerë,ata e kërkojnë arsyeshmërinë e aktit ligjor por ne nuk e kemi marrë por vetëm Drejtoria e Financave dhe zyrtari ligjor e ka marrë atë shkresë prej ministrisë.

Urim Suka - për deri sa ti ka kërku këto, nuk e ka pranuar.Silleni procedurën si duhet me ndjek, e japim pëlqimin dhe le të shkon tutje.

Avni Bytyqi - unë e thashë që as zyra e Kryetarit dhe as zyra e Kryesuesit nuk ka dokument sikur që i kthen ministria në rishqyrtim vendimet sepse sikur ta kishim, ne do ta sillnim sipas procedurave.

Fadil Hoxha - sikur me pas pas ky vendim ndryshime edhe një euro,unë e kisha sjell vet dhe nuk e kisha dërgu këtë formën.Këtu nuk ka asgjë diçka që është ndryshu.Drejtori i buxhetit më ka thënë: komentin që e ke dërgu veqantë,atë shkresë bashkangjitja këtij vendimin.Nuk e ka kthyer për që nuk pas pas diçka në rregull.Ne vetëm po ju njoftojmë.

Shefket Kolgeci - ju thatë po ju njoftojmë.A ka nevojë me votu apo nuk ka nevojë?Nëse ka nevoj me votu,sot nuk mund ta votojmë sepse nuk është në rend dite.Nëse nuk ka nevojë me votu,na njoftuat, vazhdoni dhe përgjegjësinë e merr Kryesuesi.

Selman Kolgeci - vendimi i muajit janar,a e ka marrë ligjshmërinë në ministri?Nëse e ka marrë,a jemi duke ndërhy në atë vendim që është bë i plotfuqishëm?Nëse jemi duke ndërhy në atë vendim,a lejohet me ndërhy?Nëse nuk lejohet me ndërhy,bëjeni një seancë të jashtëzakonshme nëse situata është e jashtëzakonshme,vijmë dhe e bëjmë ndryshimin.

Avni Bytyqi - e thashë që ky është vendim kolegjal që është marrë në Asamble dhe nuk mund të ndërhyjë vet Kryesuesi së paku pa u njoftu edhe ju. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime. Kryesuesi vazhdon mbledhjen me pikat e rendit të ditës.

Pika 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet pika 1.

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për këmbimin e pronës komunale me pronën private;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Selman Kolgeci - te shkresa që e ka trajtu Drejtori i Katastrës nuk figuron që është një shkresë që e ka drejtu Drejtori i Ekonomisë Labinot Halitjaha që ka thënë që nuk ka mjete me pagu këtë kompenzim.Ne jemi duke e bë kompenzimin tokë me tokë dhe jo me mjete.E di që kjo normal duhet me ra posht por vetëm le të jetë në procesverbal që kjo letër duhet me ra posht.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2 me sqarimin që e dha Selmani.

Unanimisht Miratohet pika 2

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës se paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - elaboron pikën dhe kërkon propozimet nga subjektet politike.

Aziz Bytyqi - në emër të AAK-së propozojmë Saranda Bajraktari.

Alban Berisha - grupi jonë propozon Flamur Bytyçi.

Dardan Berisha - ne nuk kemi propozim.

Liridon Fandaj - nuk kemi propozim.

Jehona Rrafshi - nuk kemi propozim

Herolind Limaj - nuk kemi propozim.

Kryetari - nga ekzekutivi propozoj Visar Kuçi,Armend Krasniqi dhe nga sektori jo qeveritar Suzana Gashi.

Kryesuesi - e hedh në votim komisionin me këtë përbërje:Saranda Bajraktari,Flamur Bytyçi,Visar Kuçi,Armend Krasniqi dhe Suzana Gashi.

22 për,1 apstenim,Miratohet Pika 3

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës se paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - elaboron pikën dhe kërkon propozimet nga subjektet politike.

Aziz Bytyqi - propozojmë Jehona Rrafshi.

Elmaze Bytyqi - propozojmë Kushtrim Kuçin.

Dardan Berisha - PDK nuk ka propozim.

Qëndrim Elshani - LVV nuk ka propozim.

Jehona Rrafshi - nuk kemi propozim.

Herolind Limaj - nuk ka propozim.

Kryetari - nga ekzekutivi propozoj Atdhe Buzhala, Bajram Shala dhe nga sektori jo qeveritar Erëza Muqa.

Kryesuesi - e hedh në votim komisionin me këtë përbërje: Jehona Rrafshi, Kushtrim Kuçi, Atdhe Buzhala, Bajram Shala dhe Erëza Muqa.

25 për, 3 apstenime, Miratohet pika 4.

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme;

Kryesuesi - elaboron pikën dhe hap debatin.

Liridon Fandaj - ne për këtë vendim kemi diskutu edhe në KPF ku ka ardhë si pikë shtesë në rend dite. Unë e kam ngrit një shqetësim edhe herën e kaluar për këtë pjesë dhe është duke u hetu nga prokuroria. Një vendim i tillë nëse merret sot atëherë ne po e ndihmojmë një diçka që nuk është e qartë. Ndarja që është bërë, është bërë pa vendim të Asamblesë. Kërkoj sqarime nga Drejtori i Pronës ose Drejtori i Urbanizmit se çka ka ndodh aty.

Armend Krasniqi - përshëndet të pranishmit. Është e vërtetë që ka një alodim që është duke u zhvillu një procedurë penale në lidhje me një parcelë afër që gjindet atje mirëpo kjo parcelë të cilën e kemi sjell ne për dhënie në shfrytëzim afatgjatë, absolut nuk ka lidhje të bëj me ndonjë proces gjyqësor, ndonjë mas nga gjykata apo nga ndonjë hetim prokuroria apo policia e shtetit.

Liridon Fandaj - nëse ajo pjesë para saj është nda kundërligjshëm, kjo parcelë nuk ka qasje në rrugë nëse ajo rrugë është nda kundërligjshëm. Nëse diçka është paraprakisht e bërë keq, mos të shkojmë prap me një vendim tjetër me marrë kundërligjshëm.

Armend Krasniqi - absolutisht jam i sigurt që parcela 252 m² e paraparë me HZK ndërtim i lartë, i plotëson të gjitha kushtet.

Liridon Fandaj - parcela tjetër ku kjo ka qasje, ndarja e asaj parcele a ka kalu në kuvend komunal?

Armend Krasniqi - HZK-ja ka parapa çdo detaj në komunën e Suharekës, i ka parapa të gjitha digasteret e ndërtimit dhe ne jemi duke u mundu me zbatu dhe absolutisht kjo parcelë nuk ka ndonjë mas ligjore e cila e diskualifikon këtë parcelë për me sjell në Asamble komunale.

Liridon Fandaj - drejtor unë po të pyes ndarja si është bërë?

Kryesuesi - ne po flasim për këtë parcelë që e ka numrin personal të vetin.

Armend Krasniqi - Drejtori jep përgjigje.

Urim Suka - prona për të cilën është bërë projekt-vendimi për me dhënë në shfrytëzim është ngjitur dhe në një formë vetëm rruga i ndan me Hendikos-in dhe në anën tjetër e ka shkollën "Skënder Luarasi". Këtë pronë ne po e japim në shfrytëzim për ndërtim por në anën tjetër e dimë që Hendikos ka kërkesë të vazhdueshme për hapësira për të zhvilluar aktivitetet e veta dhe nuk ju ka dhënë mundësi Hendikosit me pas qasje në këtë pronë dhe në anën tjetër edhe shkollës nuk e di a i duhet me u zgjeru kjo pjesë apo jo. Përtej këtyre pretendimeve ju keni zgjedh me kthi në ndërtim sepse këtë e keni parapa në Harta Zonale. Me një formë ju qysh kur janë bërë Hartat Zonale e keni pas një plan të qartë se ku po doni me ndërtu dhe kujt po doni me ia dhënë. Shqetësimi im është: kërkesa e Hendikos a do të mundet me marrë përgjigje, a do t'mund ti bëni zgjidhje për deri sa ata po kërkojnë hapësirë plus? Pretendimi që e ngriti Liridoni unë e kam kërku edhe në KPF sqarime nga zyrtari ligjor dhe po e kërkoj edhe këtu. Një pjesë aty ku është dhënë rruga jasht procedurave ligjore është në hetim dhe ky vendim që ne po e marrim, mos është

i kundërligjshëm sepse nuk kemi të drejtë me marrë vendimin për pronën më lartë sepse bie rruga për shkak të hetimit që është duke u vazhdu.

Armend Krasniqi - parcelën të cilën e kemi parapa është konform HZK-së. Është e vërtetë që Hendikos e ka bërë një kërkesë për një hapësirë ku me i vendos karrocet ose diçka tjetër. Në HZK të cilën e kemi parapa ndërtim të lartë, komuna aty i përfiton 252 m² ndërtim. Në kuadër të atij ndërtimi në 100 m mundemi me ia dhënë Hendikos për me përdor për gjërat që i nevojiten dhe 150 m² mund të bëjmë tri banesa tjera të cilat shërbejnë çoft për veteran të luftës, për familje të dëshmorëve.

Visar Kuçi - parcela kadastrale ku ka të bëjë Hendikosi në HZK janë 4 ose 5 destinime brenda një parcele. Këtu ka të bëjë me një parcelë 250 m² banim i lartë dhe e ceki edhe Liridoni që po hetohet ajo lëndë dhe nuk ka probleme sepse HZK-ja aty ku e ka parapa infrastrukturën rrugore, aty edhe ne e kemi obligim ligjor m'i bërë ndarjet e rrugëve ashtu si janë në HZK dhe ashtu kemi vepru. Pjesa tjetër ku është zonë e shërbimeve të përziera, ne jemi të obliguar që secili që aplikon për një leje ndërtimore, me njoftu që ajo parcelë duhet me hy në atë bllok të ndërtimit. Ne e shkelim ligjin nëse nuk i zhvillojmë procedurat.

Urim Suka - drejtori tha që atë ndërtim kur e bëjmë, 100 m mundemi me ia lënë Hendikos dhe më erdh mirë që një zgjidhje po i bëhet por ky vendim nëse kalon, a ka implikime me hetimet që janë duke u bërë?

Nëse edhe juristi mundet me vulos që nuk ka implikime, ne jemi për me kalu si projekt-vendim.

Avni Bytyqi - zyrtari ligjor jep sqarime dhe thotë që ligji për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe rregullorja e cila përcakton procedurat dhe kriteret për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme para se me marrë vendimin paraprak për me dhënë në shfrytëzim pronën publike, i kërkon së paku 8 kritere të plotësohen para se me shku në Asamble dhe njëri prej atyre kritereve është që prona publike të mos ketë kontest pronësor. Drejtori i Pronës së bashku me Drejtorin e Urbanizmit ju garantuan që prona për të cilën po bisedohet dhe për të cilin po pretendohet të merret vendimi në këtë Kuvend nuk ka kontest pronësor dhe nuk ka procedurë të hetimeve për parcelën në fjalë ndërsa për parcelat tjera për rreth çka ndodh ne nuk mund të paragjykojmë se çka do të ndodh me verdiktin final të sistemit të drejtësisë.

Liridon Fandaj - ajo rrugë është parapa me HZK dhe është në rregull por kur të bëhet ndarja dhe këmbimi, duhet me ardhë në Asamble dhe një vendim të tillë nuk e ka sjellë në Asamble. Nëse drejtori thotë që ka pas vendim për atë ndarje, atëherë le ta sqaron drejtori.

Visar Kuçi - ka pas ndarje sipas blloqeve ndërtimore të HZK-së ka qenë infrastrukturë rrugore. Nuk u dhënë ajo parcelë në shfrytëzim për me ardhë në Asamble por vetëm u bërë ndarja sipas HZK-së. Drejtori tutje jep sqarime.

Liridon Fandaj - çdo ndryshim në pronën publike dhe çdo ndarje duhet me ardhë në Asamble.

Visar Kuçi - e kemi të miratuar një dokument hapsinor dhe në momentin që është miratu ai dokument, ne duhet me zbatu. E them me përgjegjësi që nuk ka nevojë me ardhë çdo ndarje në Asamblenë komunale.

Selman Kolgeci - këtu po diskutohet për parcelën 545-7 dhe ajo që dua të di unë është, kjo parcelë kanë e ka parcelë amë? kur është nda kjo, prej cilës parcelë është nda? Nëse është nda prej parcelës e cila po diskutohet që është nën hetim, le ta sqaron drejtori dhe le të thotë që parcela 545-7 nuk e ka pas parcelë amë parcelën e cila është duke u hetu dhe që është nda pa miratimin e Asamblesë.

Armend Krasniqi - parcela që ka marrë numër specifik është e vërtetë që ka pas ndarje po nga e njejta parcelë që ka qenë rrugë dhe u kriju një parcelë e veçantë duke respektu HZK-në. Këtë parcelë të cilën e kemi krijuar e ka një vendim në Asamblenë komunale sëbashku me gjithë qytetin e Suharekës ku ka parapa çdo rrugë dhe çdo detaj tjetër se si duhet të ndërtohet qyteti i Suharekës. Duke u bazu në vendimin e HZK-së ne e kemi obligim me shku tutje sipas HZK-së.

Shefket Kolgeci - ne jemi asambleista dhe jemi të thirrur këtu për ta mbrojtur pronën komunale por në anën tjetër ne kemi ardhë me votat e qytetarëve dhe përveq që e mbrojmë interesin e komunës ne duhet ta mbrojmë edhe interesin e qytetarëve. Deri sa kjo është një parcelë me ndarje veq, unë mendoj që duhet ti japim dritën jeshile dhe të vazhdojë procedura.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 5.

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-016-51839, të datës 30.08.2024;

Kryesuesi - elaboron pikën dhe kërkon nga Kryetari propozimin që ta plotësoj vendimin me një emër tjetër në vend të Besa Kuçit.

Kryetari - propozon Kymete Bajraktari.

Urim Suka - ne e kemi thënë në vazhdimësi që ju si ekzekutiv punët që i keni, shpeshherë i neglizhoni. Mua më shqetëson arasyja e dorëheqjes së Drejtoreshës. Në arsyetimin që ka dhënë shkruan: arsyja e vendimit tim për dorëheqje nga ky komision vjen si rezultat i mos respektimit të afateve kohore të rregullores nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, prandaj konsideroj se angazhimi im profesional në këtë pozitë nuk mund të jetë produktiv. Do të thotë vet drejtoresha juaj po e thotë atë që ne e kemi thënë në vazhdimësi që ju po e neglizhoni atë që e keni detyrë, punën dhe kompetencat tuaja që për atë ju paguheni. Le të bëhet ndryshimi se ju i keni numrat mirëpo kërkohet përgjegjësi në ato kompetenca që merrni në përmbushjen e detyrave sipas afateve kohore që parashihen në ligjet në fuqi dhe jo neglizhenca siq po vërehet në shumë kontrata e vendime që ju duhet m'i marrë dhe nuk i merrni.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 6.

10 për, 1 kundër, 10 apstenime, Miratohet pika 6

Pika 7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-12093;

Kryesuesi - elaboron pikën dhe hap debatin.

Urim Suka - edhe ky projekt vendim që ka ardhë me u shfuqizu e fuqizon atë që thashë më herët, që ju jeni duke e neglizhu punën, madje sipas informatave që kam unë zyrtari ligjor në këtë rast ju ka rekomandu që nuk mundeni me ndjek procedurën e njejtë. Ju e keni sjell këtë procedurë në kuvend, është marrë vendimi dhe tash detyrohemi me shfuqizu për shkak që nuk e keni bërë punën si duhet atëherë, madje nuk e keni dëgju edhe rekomandimin e zyrtarit ligjor për këtë çështje.

Flamur Bytyçi - kërkoj sqarim se si ka me shku kjo procedurë tash e tutje? Si ka me qenë forma e aplikimit?

Avni Bytyqi - zyrtari ligjor jep sqarime dhe thotë që Kuvendi i Komunës në vitin 2021 e ka hartuar dhe miratuar në Kuvend një rregullore e cila i përcakton procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës publike për periudhën më pak se një vit dhe janë të përcaktuara të gjitha kushtet dhe kriteret dhe procedurat. Për ta marrë një pronë publike në shfrytëzim për periudhën më pak se një vit zhvillohet një procedurë vetëm mbi bazën e një kërkesë të një të interesuari që ka interes për ta marrë në shfrytëzim pronën publike ndërsa komuna ka për obligim që ta themelojë një komision që ta shqyrtojë kërkesën dhe ti rekomandoj Drejtorit të Drejtorisë ku është nën menaxhimin e asaj Drejtorie, ta nënshkruaj kontratën me përfituesin i cili ka përfitu që pronën me marrë në shfrytëzim.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 7.

Unanimisht Miratohet pika 7

Pika 8. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shpalljen e interesit të përgjithshëm

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Liridon Fandaj - drejtor pyetjen që e kam bërë në KPF, kam thënë se kur ka ardhë kjo kërkesë dhe ju më keni thënë një javë përpara dhe këtu po shkruan që me 20.03. ka ardhë kërkesa, pra ditën kur ne kemi mbajtur mbledhjen. Cila është urgjenca që e keni sjell këtë kërkesë të një operatori?

Armend Krasniqi - kërkesën e rregullimit të bllokut të ndërtimit të lartë nga kompania në fjalë para 6 apo 7 muajve por për disa probleme të brendshme të cilat i kanë pas për shkak të mos rregullimit të një çështje e cila ka qenë në një kontest gjyqësor. Kjo çështje ka përfundu dhe e kanë tërheq lëndën nga

kontesti gjyqësor dhe në momentin e tërheqjes së lëndës kanë kërku nga ne që me na fal 56.000€ vetëm me u marrë me këtë procedurë.Pra Komuna e Suharekës në këtë këmbim të pronës i fiton 56.000€.

Liridon Fandaj - e di që vullneti yt është me përfitu komuna por unë pyeta për urgjencën cila është dhe nëse ka pas këkesë të mëhershme është dasht me ia bashkangjit dokumentit por jo me na ardhë ditën e komisionit dhe me na thënë që kërkesa është një javë përpara.

Armend Krasniqi - nuk ka pas urgjencë për shkak se kjo si procedurë është nis para 6-7 muajsh.E vetmja urgjencë ka qenë ndoshta neglizhenca e personave që nuk i kanë kry punët me kohë dhe neglizhenca e komunës e cila e ka shty shumë për shkak të punëve të shumta që janë në drejtori.

Selman Kolgeci - ne në parim për idetë e këmbimit ku përfiton komuna normal kemi qenë pro por ajo që nuk kuptoj është që në skicën e terenit kërkohet dy pjesë të parcelave me u këmbi dhe jo vetëm një.Nuk është vetëm një 84 m që është rruga “Luigj Nikolla” por është edhe 55 m.

Armend Krasniqi - 55 m ka përfunduar si procedurë më herët dhe nuk është dasht të shënohet në skicë por është një gabim teknik.

Selman Kolgeci - para se me u votu,kjo duhet me u ndërhy në projekt-vendim dhe mos me qenë kjo e evidentuar.Çështjes së rrugës Luigj Nikolla s’ju kemi nda.Kryetar shumë keq e ke lënë!Herë merr një cop e herë një cop.Nëse mundeni me shku me intervenu dhe me renovu.

Kryetari - ajo rrugë ka qenë prone private komplet në emër të Muhamet Elshanit dhe LDK më herët ka fillu atë rrugë dhe e ka lënë përgjysmë.Kemi ardhë ne dhe vitin e parë e kemi nis,e kemi lënë përgjysmë.E kemi nis vitin e dytë,është dasht me marrë vendim dhe kemi shpall interes të veçantë dhe e kemi bërë shpronësimin afërsisht 9 ose 11 ari.Mirëpo kanë mbet shumë pjesë të vogla që kanë të bëjnë me lagjen e Gashve të fshatit Semetisht dhe në anën e djathtë kemi prona shumë të vogla.Si do çoftë me ndërtimin e objekteve të larta ne duhet ta dime që ajo rrugë është e paraparë me HZK dhe PZHK dhe besoj të ardhmen bëhet komplet.Kryetari tutje jep sqarime.

Selman Kolgeci - a mundemi me riparuar atë rrugë.E di që ka pas probleme por tash nuk ka.

Urim Suka - në skicën që e kemi thuhet që kanë me u marrë prej pales tjetër 84 m prej komunës por këtu në vendim 84 m nuk e shoh askund,po shkruan 27 m.A është gabim teknik apo çka.

Avni Bytyqi - për momentin nuk bëhet fjalë për çështje të këmbimit të pronës. Bëhet fjalë për shpalljen për interes të përgjithshëm të dy pronave private, dy pronat private që unë i kam cek në projekt-vendim,i kam marrë mbi bazën e kërkesës së DShPJ dhe ju kam referuar se çka duan të shpallin interes të përgjithshëm Kuvendi i Komunës. Çështjen e skicës edhe unë e kam vërejtë që ka qenë gabim teknik dhe nuk duhet ti referoheni skicës. 27 m² shpall interes të përgjithshëm dhe 122 m² shpall interes të përgjithshëm për dy prona private për me hap rrugën tutje për me fillu procedurën e këmbimit të pronës publike me pronën private.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 8.

24 për, 3 kundër, Miratohet pika 8

Pika 9.Pyetje dhe përgjigje;

Elmaze Bytyqi - përshëndet të pranishmit.Para disa ditësh ka përfunduar punën komisioni për ndarjen dhe vlerësimin e bursave për nxënës dhe studentë të komunës tonë.Unë si pjesë e komisionit tash e disa vite e zgjidhur nga Asambleja komunale si dhe përfaqësuese e LDK-së jam munduar që ta jap kontributin tim duke punuar maksimalisht dhe me korrektësi.Duke pas parasysh edhe numrin e madh të aplikimeve, afërsisht 800 aplikime,ne si anëtar të këtij komisioni kemi hasur në vështirësi të cilat kanë të bëjnë me kriteret që janë përshkruar në këtë rregullore.Unë për disa vite me radhë kam kërkuar që të bëhet plotësim-ndryshimi i kësaj rregullore mirëpo sot kërkoj që të mos bëhet plotësim-ndryshimi por kërkoj që kjo rregullore të hudhet poshtë dhe të formohet një rregullore për së mbari nga profesionist e fushave përkatëse.Unë jam e gatshme ta jap kontributin tim nëse drejtoria e sheh të arsyeshme.

Kryesuesi - për deri sa po kërkon me hudh poshtë,duhet me i cek edhe vërejtjet se ku janë.

Elmaze Bytyqi - mund ti bëj me shkrim sepse kemi has në shumë vërejtje.Nëse e sheh të arsyeshme drejtori për ta bërë rregulloren e re,unë do ti jap vërejtjet e mia në Asamblenë e ardhshme.

Flamur Bytyçi - po bëhen gati katër vite që e kemi emëru këtë komision dhe nuk kemi asnjë raport, andaj kërkoj nga komisioni i bursave me pas një raport prej mandatit që e ka marrë e deri tash.

Kushtrim Kuçi - kam një kërkesë për Drejtorin e Inspeksionit për kompanitë të cilat merren me operimin me kablla, kabllovik dhe të televizionit. Në momentin që e kanë bërë këputjen e kabllave nëpër tokë, shumicën e kabllave nuk i kanë largu ashtu si është e paraparë. Rasti që e kam vërejt është te ndërtesa përball gjamisë, te “Brigada 123” në dalje të Suharekës. Është mirë ti jepet vërejtje ose sugjerim.

Urim Suka - pyetje për Drejtorinë e Shëndetësisë: dua të di për fatin e ambulancës në fshatin Bllacë ku një kohë të gjatë është bërë një farë loje. Hapu një muaj pastaj mbyllu, prap hapu një kohë e pastaj mbyllu. Në planet e juaja a pritet me u hap ajo ambulance ndonjëherë apo nuk pritet të hapet fare? Pyetja e dytë ka të bëjë me rrugën që e lidh fshatin Bllacë dhe Duhël. Është një dëmtim i rrugës dhe ai është me vite dhe qytetarët aty çdo ditë ballafaqohen me ato grapa, detyrohen me kalu prej një ane në anën tjetër ku edhe shpeshherë ka pas aksidente. Unë e di që është një kontratë për mirëmbajtje dhe nuk e kuptoj pse me atë kontratë nuk intervenohet. Kërkoj nga Drejtori i Shërbimeve Publike me kontaktin me kompaninë dhe me dërgu në teren. E di që është rrugë regjionale siq më keni thënë më herët kur ju kam pyet por aty banorët po përballen me aksidente ose nëse duhet kërkonin edhe leje prej ministrisë.

Kryetari - plotësisht ke të drejtë. Edhe pse nuk është pjesë e jona është e vërtetë dhe të njëjtat probleme i kemi edhe në rrugën që shkon prej Suharekës për Reqan-Budakovë-Jezerc, problem i njëjtë është edhe Sopijë ku rruga shkon Shirokë-Sopijë-Mushtisht por ne do të mundohemi dhe në momentin që fillojnë kompanitë me punu me asfalt, duhet me i mshel dhe mos me prit prej tyre sepse qytetarët nuk e dine pjesë të kujt janë. Sa i përket ambulancës besoj që brenda muajit ka me hy në funksion.

Laureta Tafaj - e përgëzoj Elmazën për iniciativën që e ka marrë dhe të them që nëse ke nevojë dhe dëshirë, jam e gatshme me të ndihmu për atë rregullore dhe m’i sjell vërejtjet sëbashku. Dua ta pyes Drejtorin e Shërbimeve Publike për disa sanime nëpër rrugë në fshatin Grekoc. Ndoshta është e dhjeta apo pesëmbëdhjeta herë që dy mandate që të them dhe çdo herë më ke thënë po. A jemi të barabartë edhe ne qytetarët, edhe unë si këta kolegë të mi këtu apo çdo fjalë e imja, kërkesë e qytetrëve të cilët më janë drejtu mua, është e kotë? Të lutem një përgjigje për qytetarët.

Enver Shabani - përshëndet të pranishmit. Është e vërtetë që ju jeni asambleist të zgjedhur të qytetarëve por fshati ju ku jetoni në Grekoc e ka një kryesi të fshatit dhe ka një shoqatë e cila operon në fshatin tuaj dhe ne jemi në kontakt të vazhdueshëm me kryesinë e fshatit dhe me shoqatën që sipas nevojës dhe kërkesës që bëjnë, ne intervenojmë sikurse intervenojmë në fshatra tjera, andaj nuk e kemi neglizhu.

Laureta Tafaj - për kryesinë që po flet unë jam pjesë e asaj kryesie. Për atë shoqatë që po flet nuk ke të drejtë me fol sepse ajo është e ndame nga politika. Nëse unë e bëj një kërkesë do të thotë nuk qenka e vlefshme por duhet me u bërë patjetër prej kryesisë, por unë me kërkesë të tyre po flas.

Shefket Kolgeci - mbledhjen e kaluar e kam bërë një pyetje për Drejtorin e Arsimit dhe Kryetarin rreth shkollës së Vraniqit. Kërkoj një informatë më zyrtarisht se a ka shpresa që këta nxënës në shtator të këtij viti me shku në atë shkollë? Pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike: mandatin e kaluar kam kërku që në hymje të sheshit me rregullu atë Besoj që ka mundësi dhe besoj që nuk duhen shumë mjete.

Kryetari - e kanë shpall procedurën Ministria e Arsimit për komplet shkollën në fshatin Vraniq dhe në atë pjesë është edhe rrënimi i shkollës dhe unë besoj që kompania që e merr tash do ta kryen por nuk mund të garantoj a e kryen në shtator apo tetor.

Enver Shabani - disa herë kemi intervenu aty por tash e kemi një kompani që është duke u marrë me sanime dhe mirëmbajtjen e rrugëve dhe besoj që në kuadër të asaj kontrate kemi me bërë rregullimin e plotë të asaj grille ose reshefke.

Jehona Rrafshi Lumi - shqetësimet e mia janë për Drejtorinë e Shërbimeve Publike. Ka disa muaj që fshati Duhël, lagja “Rrafshi” po ballafaqohet me dëmtimin e një kanalizimi e sidomos kur ka reshje shiu. Kolegu i përmendi ato fatkeqësi që mund të ndodhin por keni parasysh që është rrezik edhe për nxënësit e fshatit Bllacë që vijnë në shkollën në Duhël. Një kërkesë me shkrim e kam dorëzuar për këtë çështje dhe shpresoj që ky problem të trajtohet me prioritet. Edhe unë shpreh shqetësimet e mia si pjesë e komisionit lidhur me vështirësitë gjatë procesit për ndarjen e bursave. Jam e mendimit se rregullorja për ndarjen e bursave kërkon ndryshim të domosdoshëm nga Drejtoria e Arsimit.

Kryetari - sa i përket problemit të kanalizimit,në moment që kryhet një kontratë që edhe më tutje përfundon sepse ju e dini që janë në OSHP,rruga e parë që duhet me u kry është kanalizimi te lagjja e Zekollve në Bllacë pastaj kalojmë në Duhël dhe shumë pjesë tjera ku kemi probleme.

Enver Shabani - në pjesën për të cilën po bisedojmë,ne disa herë kemi intervenu.Atje kemi dërgu dhe kompani private pasi siq e cekim dhe Kryetari nuk kemi ndonjë kompani që kemi kontratë të lidhur.

Liridon Fandaj - Kryetar,me datë 20.10.2023 komuna e Suharekës nënshkruan kontratë me titullin:Ndërtimi i lapidarit në fshatin Studenqan,Vraniq,Dubravë,ku vlera e kësaj kontrate ka qenë 49.950€ .Sipas informatave të banorëve pjesa e parë për Studenqanin në vlerë prej 6.900€ nuk është investu asnjëherë.Sipas pasqyrave financiare të komunës ka emetim të pagesës për operatorin ekonomikë në fund të vitit fiskal 2023.Në këtë lapidar ka vite që nuk është investuar nga koha kur banorët me vet iniciativë e kanë ndërtu. Tregu i qytetit a ka leje për punë dhe a ka pëlqim?Kush i inkason ato mjete pasi që një kontratë e një operatori që asnjëherë nuk e ke marrë mundin me qu në përmbartues ku vlera e tij është mbi 50.000€ dhe sot i njeiti operator aty iu merr taksën.Pyetje për Drejtorinë e Inspeksionit: a po i mbikqyrni ndërtimet në komunën tonë dhe a dihet se kush janë investitorët,pasi që në shumë ndërtime nuk ka tabelë të investitorit,nuk ka të njoftuar leje ndërtimi dhe po ashtu është rrezik për qytetarët pasi nuk ka rrethoja ose mbroja që qytetarët nëse ndodh një aksident mund të bien në atë pjesë.Pyetje për Drejtorin e Arsimit:Cilat kanë qenë kriteret që fëmijët janë pranë në qerdhen e qytetit dhe a ka pas njoftim? pasi aty është marrë një listë që e kanë dërgu njerëz nga zyrtarët e komunës që këtë emër duhet me pranë.Pyetje për Drejtorin e Pronës: për verifikimin e kontratave në Zonën Industriale ka dy vite e ca dhe drejtori ka premtu që brenda muajit ka me kry por ende nuk e kemi një raport se çka ka në Z.Industriale,cilat kontrata janë shkëput dhe cilat biznese kanë leje për veprimtaritë e tyre që ushtrojnë?

Kryetari - në fund të vitit 2023 ka përfunduar renovimi i lapidarit në fshatin Vraniq dhe në Dubravë.Në kodin buxhetor ka qenë edhe fshati Studenqan mirëpo me 13 qershor është bërë një lapidar duke i falemderu disa donator,nuk është bërë pagesa.Tenderi ka fillu në muajin korrik dhe ka pas punë shtesë te lapidari në fshatin Dubravë me kërkesë të familjeve të dëshmorëve,kryesisë së fshatit dhe mbikqyrësi. Lapidari ka shku edhe 6 m më lartë dhe keqpërdorim të parasë publike nuk ka.Nuk është punë në Studenqan por s'është shpenzu asnjë cent por kodin nuk kemi mujt me ndryshu sepse ashtu ka kalu në Asamble komunale.

Liridon Fandaj - emetimi i pagesës është bërë në bazë të paramasave dhe në bazë të fletpagesës për fshatin Studenqan dhe ta dëshmoj sepse e kam marrë zyrtarisht.

Kryetari - asnjë cent nuk ka shku në fshatin Studenqan.

Liridon Fandaj - le të përgjigjen për lejen dhe pëlqimin për tregun sepse aty rrezikojnë qytetarët prej tensionit të lartë.

Visar Kuçi - për pjesën që është disloku tregu prej pjesës posht në Shirokë,ka pëlqim,i ka plotësu kushtet dhe e kemi pais.Pjesa e tregut nuk është nën tela.

Liridon Fandaj - unë pyeta a ka pëlqim dhe ti më the që ka pëlqim.Unë e kërkoj atë zyrtarisht.Unë e thashë që nëse e lexon rregulloren,nuk ke të drejtë nën tension të lartë me bërë sepse janë distancat që duhet me bo.Kush e shfrytëzon dhe kush i merr mjetet prej atyre tregtarëve aty?

Armend Krasniqi - ne e kemi pas një treg të cilin e kemi shëndrru në park rekreativ,lodra për fëmijë dhe fusha të ndryshme ku qytetarët kanë ku me i zhvillu aktivitete sportive.Tregu i ri besoj që shumë shpejt do të del në ankand publik dhe pas ankandit publik kush i plotëson kriteret mundet me marrë.

Liridon Fandaj - unë të kam tregu që aty dikush është duke i marrë paratë.Nëse je drejtor duhet me kërku sepse nëse ai ka pas kontartë valide posht,nuk mundet m'u zhvendos sepse adresa ka ndryshu.Ti dhe Drejtoria e inspeksionit duhet me marrë masa që ata qytetarë ose duhet m'i pagu komunës ose jo një operatori ekonomik të paligjshëm.

Armend Krasniqi - drejtori vepron vetëm në bazë dokumentave zyrtare.Nëse ne konstatojmë që ndonjë pjesë e parcelës komunale është duke u keqshfrytëzu,atëherë merr masa Drejtoria e Inspeksionit,me njoftimin e D.Inspeksionit lirohet uzurpatori nëse e konstatojmë dhe merren procedurat sipas ligjeve në fuqi.

Gent Gashi - sa i përket ndërtimeve pa leje në komunën e Suharekës,të gjitha janë të inspektune dhe të gjitha janë me tabela informuese dhe nuk e di ku i ke pa.A mund ti cekësh?

Liridon Fandaj - unë nuk ta ceki por të sfidoj të dalim në secilën punishte dhe e shohim a i plotësojnë kushtet dhe a i kanë tabelat.

Gent Gashi - mund të vish në zyre dhe me kërkim qasje. Të gjitha ndërtimet në komunën tone janë me leje.

Remzi Bajselmani - ne si komunë e kemi pas fatin dhe falë punës së mirë e kemi bërë një ndër qerdhet më të mira në Kosovë. Me krijimin e kushteve të mira dhe çmimit shumë të lirë janë rritur edhe kërkesat. Ne si Drejtori bashkë me drejtorinë e qerdhes jemi mundu me i përmbush kërkesat por kërkesat janë shumë të mëdha. Si procedurë drejtoria e qerdhes ka pas një autonomi në kriteret për përzgjedhjen e fëmijëve për ti pranuar në qerdhe por nuk është zhvillu procedura prej fillimit sepse jemi bart prej qerdhes së vjetër në objektin e ri dhe është duke u kompletu.

Liridon Fandaj - nëse është nën menaxhimin tend si drejtori do të duhet të kesh kriteret dhe me u pranuar në bazë të kriterëve dhe jo me qenë diskriminues.

Remzi Bajselmani - e thash që jemi bartë prej qerdhes së vjetër aty dhe nuk kemi zhvillu ndonjë konkurs si DKA për pranimin e fëmijëve por kanë vazhdu sipas kushteve dhe kriterëve që janë në përputhje me ligjin.

Liridon Fandaj - nëse ti e gjen një publikim që janë pranuar ata fëmijë në bazë të kriterëve, unë të kërkoj falje. Unë po them që nuk janë pranuar në bazë të kriterëve.

Armend Krasniqi - është e vërtetë që ka ardhë si propozim për formimin e një komisionit për monitorimin e Zonave Industriale në Asambleenë komunale mirëpo për shkak të përgjegjësisë të larta zyrtarët e Asamblesë nuk kanë pranuar që të jenë pjesë e komisionit dhe Kryetari i Komunës ka vendosur ta bëjë një komision tjetër i cili komision me përpikmëri është duke i kryer detyrat të cilat i ka të caktuara me vendimin e Kryetarit dhe shumë shpejtë do ta keni një raport përfundimtar në lidhje me situatën që është në Zonën Industriale.

Liridon Fandaj - unë të pyeta a ka përfunduar raportin sepse ti mu ke përgjigj dhe ke thënë brenda muajit. Nëse ka përfunduar, unë zyrtarisht e kërkoj të Kryetari dhe shoh cilat janë të gjetur.

Armend Krasniqi - jemi në përfundim të komisionit dhe shumë shpejt do ta ketë zyra e Kryetarit.

Liridon Fandaj - a ke informatë sa biznese veprojnë jashtë veprimtarisë së vet?

Armend Krasniqi - komisioni ka me paraqit një raport detaj dhe do të keni mundësi të ballafaqoheni shumë shpejt me detajet.

Urim Suka - Drejtori na akuzoi si Asamble dhe tha disa të pavërteta. Është përgjegjësi e Kryetarit të Komunës çdo gjashtë muaj të raportojë para Asamblesë për pronat që jepen në shfrytëzim. Ky raport neve gati kurrë nuk na ka ardhë. Kërkoj që çdo gjashtë muaj të respektohet ligji dhe Kryetari të raportoj Kuvendit të komunës për kontratat që i ka lidh me operatorët ekonomik për shfrytëzimin e pronave komunale.

Armend Krasniqi - Drejtoria e Pronës paraqet çdo tre muaj raporte detale për punët të cilat i bën në drejtori dhe mund ti gjeni në faqen zyrtare të komunës së Suharekës.

Selman Kolgeci - fillimisht dua ta nis dhe të vazhdoj çështjen e lapidarëve ku e nisi Liridoni. Unë me 24.05.2024 iu kam drejtuar me një email dy drejtorëve ku kam kërkuar në mesin e tri projekteve çasje zyrtare dhe një prej tyre ka qenë ndërtimi i lapidarëve në Studenqan, Dubravë dhe Vraniq për shkak se në Vraniq kur e kam pa që janë pagu mjetet por sasia që ka qenë në paramasë nuk korrespondu me sasinë e punëve që janë kryer. Prapë ju bëj thirrje publikisht që ta sjellin materialin për lapidarian në fshatin Vraniq, Dubravë dhe Studenqan. Kërkoj sqarime nga Kryetari dhe drejtorët të cilët disa projekte janë duke i menaxhuar. Dua të di për dinamikën e projekteve të cilat veç kanë qenë në proces që nga viti 2024 dhe nga viti 2023 dhe unë besoj që edhe këtë vit auditori ka me gjet projekte të cilat kanë kalu plane dinamike dhe nuk po realizohen. Si, avantazhi që i bëhet kompanive të caktuara në raport me kompanitë që nuk janë të favorizuara është pikërisht plani dinamik. Po e nis te procedura me kriterin oferta e përgjegjshme ekonomikisht më e favorshme duke vendosur kriter të rëndësishëm në planin dinamik e pastaj po i njejtë kriter nuk po respektohet por po shërben vetëm sa me favorizim ndonjë operator ekonomik gjatë fazës së konkurimit duke e dëmtuar edhe buxhetin por edhe konkurrencën e drejtë. Çështjet tjetër është niveli i dëmtimeve të rrugëve dhe pyes se kur ka me fillu sanimi. Dua të shpreh shqetësimin për rrugët të cilat po i nënshtrohen ngarkesave të makinerive të rënda në afërsitë e vendeve ku po ndërtohen objektet shumëkatëshe. Nuk jam kundër ndërtimeve por nuk është në rregull dikush me ndërtu një objekt për

biznes dhe me dëmtu imfrastrukturën publike. Ka forma që munden me apliku për matjen e ngarkesës së kamionave dhe mos me leju me qarkullu automjetet të cilat i tejkalojnë aftësitë mbajtëse të rrugëve. Rrugët për të cilat po flas janë vazhdimi i rrugës “Indrit Cara” përtej lumit që lidhet me restorant “Shpatin”, rruga “Pavarësia, Migjeni, Adem Kuçi, Vudro Villson, Milit Kryeziu”, etj. Çështje tjetër është rruga “Manza” dhe rruga e Dëshmorëve. Në rrugën “Manza” vitin e kaluar e patëm një fatkeqësi ku një qytetare e jona humbi jetën në atë rrugë dhe as një hap nuk është ndërmarr për me ofru siguri në atë rrugë. Si ka mundësi mos me u ndërtu trotuari aty? Kryetar ose ndërtoje trotuarin aty, ose vendose një shenjë që nuk lejohen me lëvizë kombësorët në atë rrugë ose ndaloj automjetet prej orës 8 në mbrëmje. Sa herë bie shi, shumë shpesh ka aksidente te vendi i quajtur Hisari. Aty unë propozoj me analizu pjerhtësinë tërthore dhe nivelin e koeficientit të fërkimit të asaj shtrese qarkulluese të asfaltit. Është një kërkesë që më ka ardhë prej familjes së heroit të Kosovës Ilir Llapatinca i cili ka ra në detyrë në vitin 2004 dhe kërkesa e tyre ka të bëjë me ndarjen e një parcele me nr. 1158-8 në zonën kadastrale në Suharekë në “Sllogja” ndërsa për ndërtimin e shtëpisë i marrin përsipër me i bartë vet. Këtë kërkesë pala e ka drejtu te ju Kryetar dhe sipas saj asnjëri nuk i është përgjigjur. Kërkoj nga zyrtari ligjor dhe drejtori i Pronës që këtë kërkesë me trajtu dhe në seancën e ardhshme me i dhënë përgjigje kësaj kërkesë.

Avni Bytyqi - para se m'u miratu ligji për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme, që në vitin 2010 Kuvendi i Komunës ka nda kohë pas kohe prona në shfrytëzim për ndërtimin e shtëpive individuale, sidomos të komuniteteve pakicë. Me hyrjen në fuqi të ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës një gjë e tillë nuk e lejon ligji që ndahet prona publike për ndërtimin e shtëpive në mënyrë individuale.

Kryetari - te rruga e lagjes Osoja, ajo rrugë në atë kohë është bërë rrugë fushore dhe nuk e kemi ditë çka do të bëhet me HZK dhe PZHK por në moment që kryhen ndërtimet ajo rrugë bie posht pasi që nuk ka qenë rrugë për banim. Të gjitha kompanitë që ndërtojnë paguajnë taksën në komunë dhe në moment që kryhen punët rruga rregullohet, duhet të bëhet edhe kanalizimi, uji dhe infrastruktura. Renovimet e rrugëve fillojnë. Tek rruga që ceke që ka rrezikshmëri, ne do ta bëjmë trotuarin dhe së paku me vendos shenja orientuese pasi ajo pjesë është e rrezikshme.

Reshat Selimaj - përshëndet të pranishnit. Kam tre shqetësime për Drejtorinë e Shërbimeve Publike ku janë dy rrugë thuajse të pakalueshme. Është rruga “Zenel Isufi” dhe rruga e shkollës. Shqetësimi më i madh është te ndriçimi publik. Është e pamoralshme, e pamenaxhim, që dy muaj me thirr një kompani dhe për një sensor me mbet në terr fshati.

Enver Shabani - e dinë edhe Reshati, kemi pas kontakt. Kontrata në fjalë ka dy menaxher që janë ekspert të fushave dhe menaxheri i kontratës më ka thënë që do të merret me këtë çështje.